



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800764/3

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandim për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë të strukturës operationale të DVP Tiranë.*

Drejtuar : **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**
Drejtues Madhor Ardi VELIU

Tiranë

I nderuar zoti Veliu,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja S.D.. Ankuesja shkruan se, në datën 15.04.2018, rreth orës 01:00- 02:00, djali i saj i quajtur D.D. ka qënë duke udhëtuar me makinë në qytetin e Tiranës së bashku me dy shokët e tij, A.C. dhe L.F., në drejtimin nga Shkolla "Vasil Shanto" për te "21 Dhjetori". Makinën e drejtonte D., i cili ka qënë pak shpejt mbi normën e lejuar nga Kodi Rrugor. Në momentin që ata ishin tek kryqëzimi i rrugës "M. Shyri" me rrugën "M. Gjollesha", janë ndaluar nga dy furgona policie dhe një mjet fuoristradë civile. Punonjësit e policisë i kanë urdhëruar ata të tre që të dilnin nga makina. Ankuesja pretendon se në momentin që djali i saj, D., ka ndaluar makinën punonjësit e policisë e kanë nxjerrë me dhunë atë, e kanë lidhur me pranga dhe e kanë dhunuar fizikisht. Si pasojë e dhunës së ushtruar dhe përplasjes së kokës në pjesën e sipërme të makinës, atij i është shkaktuar hemoragji në buzën e poshtme. Më pas punonjësit e policisë e kanë shoqëruar atë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku i është bërë testi i alkoolit i cili ka rezultuar negativ dhe nga ky organ e kanë dërguar në Komisaratin e Policisë nr. 2 Tiranë. Meqënëse D. kishte dëmtime fizike, Komisarati i Policisë nr. 2 Tiranë e ka dërguar atë për ekzaminim dhe mjekim në Spitalin Ushtarak Tiranë. Gjatë kohës së qëndrimit të D. në këtë spital, ankuesja i ka bërë atij disa foto ku duken shënjat e dhunës që ankuesja pretendon se i janë shkaktuar nga punonjësit e policisë. Pasi ka qëndruar disa orë në spital i shoqëruar nga punonjësit e policisë, ai është dërguar përsëri në Komisaratin e Policisë nr. 2 Tiranë ku është arrestuar për veprat penale të "Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit" dhe atë të "Goditjes së punonjësit të policisë". Tre ditë pas qëndrimit në gjëndje arresti, D. është dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë për vleftësim dhe caktim të masës së sigurimit. Gjykata e ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e tij në flagrancë dhe ndërkohë ka caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg me afat 30 ditor".

Ankuesja pretendon se arrestimi i djalit të saj është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse ai nuk ka kryer asnjë nga veprat penale për të cilat është arrestuar nga policia. Sipas ankuses, arrestimi i D. është bërë për arsye të justifikimit të dhunës së ushtruar ndaj tij nga punonjësit e policisë. Pretendimet e saj ajo i mbështet në deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm, dy shokëve të djalit, A.C. dhe L.F.. Gjithashtu sipas ankuses, njëri prej shokëve të djalit të saj ka bërë edhe një inçizim të bisedës që ai ka bërë me punonjësit e policisë, nga e cila rezulton se personi që e goditi D. e pranon këtë fakt. Përveç sa më sipër, ankuesja na njoftoi se në datën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje kishte bërë kallëzim tek Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë.

Menjëherë pas marrjes dhe administrimit të kësaj ankese, nga Avokati i Popullit u urdhërua fillimi i menjëhershëm i hetimin administrativ të këtij rasti. Në kuadër të kryerjes së hetimeve administrative punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit të ngarkuar me ndjekjen e këtij rasti shkuan në IEVP 313 Tiranë dhe morën takim me të arrestuarin D.D., i cili u pyet me procesverbal në mënyrë të hollësishme rreth ngjarjes së ndodhur me të. Gjithashtu u pyetën me procesverbal edhe dy shokët e tij, A.C. dhe L.F., të cilët kanë qënë prezent në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

Nga pyetja e shtetasve D.D., A.C. dhe L.F. rezultoi se, shtetasi D.D. është dhunuar fizikisht nga një punonjës policie i cili ishte civil dhe që sipas tyre duhet të ishte shefi i grupit të punonjësve të policisë. Sipas tyre, e vetmja shkelje ligjore që ka kryer shtetasi D.D. në datën 15.04.2018, ka qënë qarkullimi i tij me automjet me shpejtësi tej normave të lejuara nga Kodi Rrugor. Sidoqoftë kjo lloj shkeljeje është kundërvajtje administrative dhe jo vepër penale. Gjithashtu nga deklaratimet e tyre rezultoi se, shtetasi D.D. nuk ka kryer asnjë vepër penale nga ato për të cilat ai është arrestuar në flagrancë, sepse nuk ka kundërshtuar apo goditur punonjësit e policisë.

Meqënëse ankuesja na informoi se për këtë rast kishte bërë kallëzim në SHÇBA Tiranë, në datën 30.04.2018 punonjësit e institucionit tonë shkuan dhe u interesuan në drejtorinë e këtij institucioni lidhur me mbarëvajtjen e kallëzimit. Nga punonjësit e SHÇBA-së Tiranë morën informacion se kallëzimi i bërë nga prindërit e shtetasit D.D. dhe materialet e tjera procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë me shkresën nr. 63 prot., datë 16.04.2018. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 3120, datë 20.04.2018 për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Pas fillimit të procedimit penal, prokurori i çështjes ia ka deleguar atë për kryerjen e hetimeve në Drejtorinë e SHÇBA-së Tiranë. Përveç sa më sipër, nga punonjësit e SHÇBA Tiranë, u informuan se nga ana e tyre është pyetur edhe njëri prej dëshmitarëve që ka qënë i pranishëm në momentin e ndodhjes së ngjarjes, shtetasi L.F., si dhe është administruar edhe një CD me inçizimin i bisedës që ky i fundit ka bërë me punonjësin e policisë që ka dhunuar D.. Ndërkohë ata u njoftuan se nga OPGj i Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë, që ka kryer veprimet procedurale lidhur me këtë rast dhe arrestimin e shtetasit D.D. është marrë vendim për ekzaminimin mjekoligjor të tij. Gjithashtu, punonjësit tanë u informuan se punonjësit e policisë që kishin ndaluar dhe kontrolluar shtetasin D.D. ishin efektiv të strukturës operationale të DVP Tiranë.

Bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm në këtë ngjarje, në faktin që i arrestuari D.D. natën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje nuk kishte përdorur pije alkoolike dhe është një person me përmasa dhe peshë trupore të imta, si dhe numrit të madh të punonjësve të policisë rreth 10 persona, gjukojmë se ai nuk ka pasur arsye për të kryer veprat penale për të cilat është arrestuar. Përveç kësaj ai është dhunuar fizikisht nga njëri prej punonjësve të policisë, ndërkohë që nga hetimi ynë administrativ nuk na rezulton që të ketë qënë e nevojshme as përdorimi i forcës ndaj tij.

Ndodhur në këto rrethana, kur për të njëjtën ankesë dhe ngjarje organi i prokurorisë ka filluar procedimin penal ndaj punonjësve të policisë për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, vendosëm që të mos i drejtohem këtij organi me rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë. Është detyrë dhe e drejtë e organit të prokurorisë që të bëjë një hetim profesional, objektiv, të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me procedimin penal të filluar ndaj punonjësve të policisë, si dhe ndaj të arrestuarit D.D..

Megjithatë, nisur nga ky rast e gjykojmë të arësyeshme që t’ju sjellim në vëmendje faktin se, herë pas here në institucionin tonë janë administruar edhe raste të tjera ankesash të qytetarëve, të cilët kanë pasur pretendime për dhunim apo për arrestime të paligjshme nga punonjësit e Policisë së Shtetit për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” dhe atë të “Goditjes së punonjësit të policisë”. Ne mendojmë se punonjësit e policisë duhet të edukohen e trajnohen që të sillen dhe komunikojnë me qytetarët me etikë, durim dhe profesionalizëm. Ata duhet të tregohen të kujdesshëm që në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative, të mos bëhet shkak për ndodhjen e incidenteve të pahijshme dhe kryerjen e veprave penale si ato të cituara më sipër nga shtetasit apo më keq akoma që për të justifikuar një veprim të paligjshëm të tyre ndaj qytetarëve të bëjnë kallëzime të rreme. Kjo mënyrë sjelljeje e disa punonjësve të policisë vjen në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Polinë e Shtetit” ku parashikohet se:

“Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”.

Gjithashtu ajo vjen në kundërshtim edhe me nenin 94 të këtij ligji i cili parashikon se:

“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave....”

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

1. Fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë të strukturës operacionale të DVP Tiranë nga Drejtoria e Performancës dhe e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Nxjerrjen e përgjegjësive, dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

3. Trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë së shtetit me synimin respektimin e të drejtave të shtetasve, sjelljes së tyre me etikë gjatë përmbushjes së detyrave dhe zbatimin e parimit të proporcionalitetit në se lind nevoja e përdorimit të forcës konform nenit 123 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe fotokopje të dokumentave të mëposhtme:

1. Procesverbali administrativ i pyetjes së shtetases S.D. i mbajtur në datën 26.04.2018.
2. Procesverbali administrativ i pyetjes së shtetasit D.D., i mbajtur në datën 26.04.2018.
3. Procesverbali administrativ i pyetjes së shtetasit A.C., i mbajtur në datën 30.04.2018.
4. Procesverbali administrativ i pyetjes së shtetasit L.F., i mbajtur në datën 30.04.2018.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI